



C.nr.113/09

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ- Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtesen Minrie Krasniqi, ne ceshtjen e inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] [REDACTED] kunder te paditurive [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] dhe [REDACTED] me parë nga fshati [REDACTED], tani me adresë të panjohur të cilin e përfaqëson përaquesusi i përkohshëm av. [REDACTED], per vertetim pronesie, ne séance e mbajtur me date 22.11.2016, merr kete:

A K T G J Y K I M

- ne baze te pohimit -

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED], dhe **VËRTETOHET** se paditësi është pronar i paluajtshmerisë me numër të njësisë kadastrale P-72217068-00557-0, vendi i quajtur "Kodra", me sipër. 6200m², në Zonën Kadastrale Pleshinë K.Ferizaj.


OBLIGOHEN të paditurit [REDACTED] dhe [REDACTED] që paditësit t'ia njojin te drejtën e pronësisë mbi këtë pronë dhe të i lejojnë regjistrimin e saj ne regjistrat kadastral të tij, ketë në afat prej 15 ditësh pas pranimit te kopjes së tij, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërben paditësit si autorizim për të bërë regjistrimin e pronës në emër të tij.

OBLIGOHET paditësi që të bëjë pagesën e shpenzimeve për përfaqësim nga përfaqësuesi e përkohshëm i të paditurit, shpenzimet e ekspertit te gjeodezise në shumë prej 100€ si dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 60€ dhe për aktgjykim ne shume prej 80€, ne afat prej 15 ditesh pas pranimit te ketij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Paditesi ka pretenduar me padi se në vitin 1975, nga paditësi i parë e ka blerë njësinë kadastrale P-72217068-00557-0, vendi i quajtur "Kodra", me sipër. 6200m², në Zonën Kadastrale Pleshinë K.Ferizaj, në bazë të marrëveshjes gojore, por i njejti nuk ka mundur te regjistrohet si pronar i saj për shkak te pengesave ligjore te pushtetit te atëhershëm, si dhe ka permbushur ne teresi detyrimet lidhur me pagesen e cmimit dhe ka marr ne posedim te papenguar pronën nga i padituri i parë. Ka kerkuar t'i njihet e drejta e pronesise mbi bazen e shitblerjese dhe të posedimit me mirebesim.

Gjykata, fillimsh, ka aprovuar propozimin e paditësit që të paditurit të dytë t'i caktohet përfaqësuesi i perkohshem, meqenese i njejti është shpërngulur jashte Kosoves dhe se nuk ka mundesi që sigurojë ndonje informacion, per vendndodhjen e tij.



Gjykata aktvendimin per caktimin e perfaquesuesit te perkohshem e ka publikuar ne gazeten zyrtare te Republikes se Kosoves dhe ne tabelen e shpalljeve te kesaj gjykate.

Përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDACTED] nga [REDACTED], në përgjigjen në padi ka kontestuar kërkesë padinë e paditësit në tërsi si të pa bazuar.

Në seancën përgatitore të çështjes si dhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor paditësi ka theksuar se ngelet pranë paditës dhe kërkesë padisë si dhe theksimeve të cekura në të. Po ashtu i njejti ka deklaruar se për njësin kadastrale objekt kontesti e ka blerë në vitin 1975 nga paditësi i parë dhe se ndaj tij i ka përbushur të gjitha obligimet ligjore për sa i përketë çmimit të shitblerjes.

I padituri i parë [REDACTED] në seancën përgatitore të çështjes ka deklaruar se nuk e konteston kërkesë padinë e paditësit dhe se është e vërtet se i ka shitur pronën objekt kontesti paditësit, e të cilën pronë më parë e kishte blerë nga një serb, dhe se te njejtën pronë e ka pasurë në posedim dhe është sillur si pronar i saj deri në ditën kur të njejtën i'a ka shitur paditësit.

Perfaqësuesi i perkohshem av. [REDACTED] nga [REDACTED], në seancën përgatitore e ka kontestuar kërkesë padinë e paditësit, mirëpo gjatë shqyrtimit kryesor të çështjesë dhe në fjalën e tij përfundimtare nuk e ka kontestuar kërkesë padinë e paditësit si dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta aprovojë si të bazuar, sepse ka konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore që i njejti të njihet si pronarë ligjorë i pronës objekt kontesti.

Gjykata ka aprovuar këresëpadinë e paditësit si të pohuar duke qenë se në mes palëve ndërgjygjëse nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se i padituri i parë dhe perfaqësuesi i perkohshëm i te paditurit të dytë shprehimisht ka pranuar kerkespädine dhe në anën tjetër, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrëthanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e cila do te pengonte aprovimin e kërkesëpadisë dhe rrëthana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadisë nga ana e përfshuesit të perkohshëm të të paditurit, ndaj ne kuptim te nenit 148 të LPK-së, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata me qellim te vertetimi te rrëthanave lidhur me poziten dhe shtrirjen e prones kontestuese ka bere identifikimin e saj permes ekspertit te gjeodezise me ane te te cilit ka percaktuar paramasat dhe kusizimet e pronës objekt kontesti, nga ku ka sqaruar sipërsfaqen e pronës objekt konteskti, pozicionimin e saj- shtrirjen kadastrale ne zone, pronaret juridik te saj dhe shfrytezuesi aktual te saj dhe per keto te gjetura te ekspertizes gjykata i ka pranuar ne teresi si professional dhe ne perputhje me gjendjen faktike dhe zyrtare, si dhe ka bërë administrimin e provave të tjera certifikatën e pronës, reportin përshkruar dhe skicën e matjeve.


Gjykata ka obliguar paditësin që të paguaj shpenyimet e procedurës dhe atë per perfaqësim te paditurit nga perfaqësuesi i perkohshem në bazë të tarifave të OAK-së ne kuptim te nenit 81 par.2 lidhur me nenin 453 te LPK-se, shpenzimet e ekspertit të gjeodezisë në shumë

prej 100€ në kuptim të nentit 451 të LPK-së, ndersa taksën për padi në shumë 60€ dhe per aktgjykim ne shume prej 80€, ne baze te nenit 445 te LPK-se.

Mbi bazën e parashtrimeve te mesiperme eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.113/09, me datën 22.11.2016



Gjyqtari,
Eres Mehmeti
[Signature]

KËSHILLË JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi mund te ~~te nuk~~ nukese ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te tij, ne Gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj Gjykate.

